



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVA

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA


Ministria për Punë, Familje dhe Vlerat e Luftës Çlirimtare / Ministarstvo Rada,  
Porodice i Vrednosti Oslobodilačkog Rata / Ministry of Labor, Family and Values of  
the Liberation War



Inspektorati Qendror i Punës/Centralna Inspektorat Rada/Central Labour Inspectorate

02V-02-26/1426

24.03.2026



**INSPEKTORATI I PUNËS**

Inspektori i Punës [redacted], bazuar në dispozitën e nenit 2 dhe 5 të Ligjit nr.2002/9 dhe Ligjit nr.03/L-017 për Inspektoratin e Punës në Kosovë, Ligji per Inspektimet Nr.08/L-067 neni 21 dhe neni 25, dispozitën e nenit 2 paragrafi 1, neni 82 dhe neni 94 të Ligjit të Punës në Kosovë Nr.03/L-212, Ligji nr.08/L-283 për Harmonizimin e Ligjeve të Veçanta me Ligjin nr.05/L-087 për Kundërvajtje, dispozitën e nenit 44, neni 47, neni 97 të Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, procesverbalit i inspektimit 02-02-26/1426 ,të dt.21.01.2026, procesverbalit të ri-inspektimit 02-02-26/1426A, të dt.09.02.2026, vërejtjen ndaj procesverbalit zyrtar të riinspektimit nr.02.-02./26/1426A me nr.prot.66/26 e dt.05.03.2026, si dhe procesverbalin e riinspektimit nr.02-02-26/1426B të dt.05.03.2026, lidhur me ankesën me nr.07/26, të datës 15.01.2026, pala ankuese [redacted] ndaj subjektit juridik “ Kosova Med Healthcare”SH.P.K., në QKMF në Skenderaj, me datën: 24.03.2026 nxjerr:

**V E N D I M**

Përfundon procedura administrative lidhur me parashtrësën nr. 07/26 të dates 15.01.2026; nuk janë gjetur shkelje të dispozitave ligjore në marrëdhënien e punës, të paraqitur nga pala ankuese [redacted], në cilësin e sinjalizuesit, kundër subjektit juridik “Kosova Med Healthcare”SH.P.K., në QKMF në Skenderaj,, në IQP-në në Mitrovicë, me njoftimin e këtij akti administrativ.

**A r s y e t i m**

Inspektori i Punës [redacted], me [redacted] i autorizuar me dispozitat e nenit 82 paragrafi 1, nenit 92 dhe neni 94 të Ligjit nr. 03/L-212 të Punës, dispozitat e neneve 1, 2 dhe 5 të Ligjit nr. 2002/9 për Inspektoratin e Punës në Kosovë, Ligjin nr. 03/L-017 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Inspektoratin e Punës nr. 2002/9, Ligji nr.08/L-283 për Harmonizimin e Ligjeve të Veçanta me Ligjin nr.05/L-087 për Kundërvajtje, Ligjin nr. 08/L-067 mbi Inspektimet, si dhe në bazë të vërejtjes ndaj procesverbalit nr.02-02/26/1426A të dates 09.02.2026 nga subjekti juridik

- "Kosova Med Healthcare" SH.P.K., pas kontrollimit të dokumentacionit dhe administrimit të provave të tjera relevante, konstaton këtë gjendje faktike:

Me rastin e riinspektimit dhe shiqimin e dokumentacionit në subjektin juridik "Kosova Med Healthcare" SH.P.K. (punëdhënësi), me adresë në New Prishtina Residenc, A20, Çagllavicë Prishtinë, me pronar [REDAKTUAR] lidhur me parashtrësën e palës me nr. protokolli 07/2026, të datës 15.01.2026, të parashtruar përmes emailit nga një palë e tretë në adresë të Zyrës së Inspektoratit të Përgjithëshum.

*Pala ankuese ankohet se ka; „shkelje te vazhdueshme të të drejtave të punëtorve që ushtrojnë veprimtarin në Qendren Kryesore të Mjeksis Familjare në Skenderaj, konkretisht citon dy punëtorë se janë të punësuar në Kosova Med, të cilët janë të angazhuar në shërbimin e urgjencës në QKMF – Skenderaj në ndrrime 12- orëshe me kujdestari, pala ankuese thot se janë te detyruar te punojnë vetem ne kujdestari dhe jane detyruar të deklarjon se punojn me dëshirë”.*

Lidhur me këtë ankesë, më datën 21.01.2026 është zhvilluar inspektim në QKMF në Skenderaj, lidhur me punonjësit e kompanisë „Kosova Med Healthcare” SH.P.K. e kontraktuar nga komuna e Skenderajt për; **Shërbimet e kujdesit social, shëndetësor, shtëpiak dhe ambulatorë në QKMF Skenderaj**. Prezent gjatë inspektimit ka qenë [REDAKTUAR] (kordinatora), kemi marrur deklarata te punëtorëve të subjektit të cekur me lartë, të cilat kanë deklaruar se; „*punojnë shtatë orë në ditë dhe njëherë në muaj angazhohemi ne kujdestari dymbëdhjet orëshe me qëllim për të plotësuar numrin e orëve*”. Po ashtu gjatë inspektimit kordinatorja e punëtorve Kosova Med Healthcare SH.P.K., ka prezantuar edhe kërkesat e dy të-punësuarve me nr 133/25 e datës 26.02.2025 dhe nr.134/25 e datës 26.02.2025, të cilët kërkojnë nga QKMF në Skenderaj që të ju mundësohet; „ *të punojnë kujdestar vullnetar ne emergjencë pa pagesë shtesë*”.

Me procesverbalin nr. 02—02/26/1426 të datës 21.01.2026, subjektin e inspektuar e kemi obliguar në prezantimin e dokumentacionit si vijon;

1. Kontratat e punës;
2. Evidencën e hyrje-daljeve për tre muaj;
3. Listën e pagave dhe të punëtorëve nga ATK-ja;
4. Kontratën në mes të Kosova Med Healthcare SH.P.K dhe Komunës së Skenderajt ;

Po ashtu përmes emailit me datë 26.01.2026, përmes kordinatorës [REDAKTUAR] kam kërkuar dokumenta shtesë , listen e pagave nga ATK-ja dhe listen e pagave të ekzekutuara në bankë për punëtorët e Kosova Med Healthcare SH.P.K., për dy ,muajt e fundit, konkretisht nëntor dhe dhjetor 2025.

Nga sa u cek më lart, punëdhënësi, sipas obligimeve të dhëna me procesverbalin zyrtar nr. 02-02/26/1426, ka prezantuar dokumentacionin e kërkuar nga Inspektorati i Punës, si vijon:

1. Listën e pagave te ekzekutuara në bank;
2. Kontratat e punës;

3. Evidencën e hyrje-daljeve për tre muaj;
4. Listën e pagave dhe të punëtorëve nga ATK-ja;
5. Kontratën në mes të Kosova Med Healthcare SH.P.K dhe Komunës së Skenderajt.

Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit me rastin e riinspektimit, kemi kontaktuar dy punëtorët për të cilët na është thënë nga kordinatōrja e punëtorëve të Kosova Med Healthcare SH.P.K., se me kërkesën e tyre ju është ndrruar orari i punës dhe kanë kërkuar që të angazhohen vetem në kujdestari, të dy punëtorve ju kemi marrur nga nje deklarate me qellimin se a qendrojn pas kërkesave për tu angazhuar vetem në kujdestari, të dytë kanë deklaruar se me vullenetin e tyre të plotë pa u ndikuar nga askush kanë kërkuar të punoj vetem në kujdestari, deklaratat e tyre jane pjese e këtij procesi. Nga shiqimi i evidencave të hyrje daljeve shihet se nuk ka tejkalim te orëve, lidhur me angazhimin e tyre, ndërsa në lidhje me kujdestari janë kompenzuar me ditë të pushimit, shihet edhe ne evidencenë hyrje daljeve në punë. Andaj bazuar në nenin 23, par.4 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, thuhet; „ Përveç punës shtesë të detyrueshme nga paragrafi 1. i këtij neni, i punësuari mund të bëjë punë shtesë vullnetare në marrëveshje me punëdhënësin, me kompensim page sipas nenit 56 të këtij ligji”, dhe nenin 56 par.4 dhe 5 ku thuhet;„ I punësuari mund të kërkojë nga punëdhënësi që në vend të pagës shtesë nga paragrafi 2. i këtij neni, kompensimi t'i bëhet me ditë pushimi; Punëdhënësi mund të vendosë që një pjesë të punës jashtë orarit të kompensohet me ditë pushimi, në përputhje me përqindjet e parapara në paragrafin 2. të këtij neni. Kjo formë e kompensimit duhet të parashihet në Kontratën e Punës ose në Aktin e Brendshëm të kompanisë”.

Kurse gjatë shiqimit të kontratave kemi vërtur se gjatë ekzekutimit te pagave për muajin nëntor dhe dhjetor nuk është ekzekutuar paga te tri punëtorë sipas kontratës të nënshkruar mes punëdhënësit dhe punëmarrësve, konkretisht me te punësuarat [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] kontrata të lidhura në vitin 2025, po ashtu punëdhënësi ka prezantuar një kontratë të lidhur me të punësuarën [REDAKTUAR], ku nuk është respektuar vendimi për pagën minimale nr.10/273 të datës 31.10.2025, që përcakton pagën minimale për vitin 2026.

Mirë po pas tentimit të dërgimit të procesverbalit nr.02-02/26/1426A të datës 09.02.2026, përmes poste në adresën e “Kosova Med Healthcare” SH.P.K., në fletëkthesë nga posta është deklaruar si adresë e panjohur, pastaj subjektit të inspektuar ju është dërguar procesverbali përmes emaili. Me datën 04.03.2025 subjekti i inspektuar përmes departamentit ligjor ka kundërshtuar porcesverbalin e datës 09.02.2026, duke prezantuar prova të reja si; Vendimet për lejimin e shfrytëzimit te pushimit të lehonisë, kontratën e punës të korrigjuar për vitin 2026 për [REDAKTUAR], dhe listën e pagave të egzekutuar për muajin janar 2026.

Andaj nga shiqimi i këtyre provave kemi ardhur ne përfundim se shkelja e konstatuara me procesverbalin e datës 09.02.2026 me nr.02-02/26/1426A nuk qëndron, dhe me këtë rast inspektimi i filluar në bazë të parashtresës nr.07/26 përfundon pa vërejtje.

Andaj, lidhur me pretendimet e pales ankuese, kemi vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

Punëdhënësi mbetet i obliguar të vazhdojë respektimin dhe zbatimin e dispozitave të ligjeve në fuqi.

Ky vendim është përpiluar në ekzemplarë të mjaftueshëm identik; nga një (1) ekzemplar i dorëzohet palëve, ndërsa ekzemplarët tjerë Inspektori i Punës i mban për procedurë të mëtejshme.

Pasi që nuk kemi adresë të palës ankuese, ky vendim do ti dërgohet përmes emailit që është ankuar në Inspektoriatin Qendror të Punës.

Data: 24.03.2026

Mitrovicë.

**INSPEKTORI I PUNËS**



**Udhëzim juridik:** Kundër këtij Vendimi mund të bëhet ankesë në afat prej 30 ditësh, pas marrjes të këtij vendimi, nëpërmes Inspektorit të Punës në Mitrovicë, Rruga: "Afrim Zhitia", (Objekti i Administratës Pensionale) kati II, zyrja nr.34. Mitrovicë.